



safejournalists.net

Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor

Raporti Narrativ i Kosova 2021

PËRMBAJTJA

MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

10

PARANDALIMI I DUHUR

22

PROCESI I RREGULLT

33

SIGURIA AKTUALE

43

Hyrje

Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor (ISG-BP) është një instrument i bazuar në hulumtime, i krijuar për të matur dhe monitoruar ndryshimet në mjediset përkatëse sociale dhe politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në sigurinë e gazetarëve dhe akterëve të medias gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. ISG-BP mbështetet kryesisht në provat hulumtuese të mbledhura dhe analizuara nga partnerët e Safejournalists.net një platformë që zbaton një procedurë rigoroze të hulumtimit. Të dhënat e mbledhura mbi dimensione të ndryshme të konceptit kompleks të 'sigurisë së gazetarëve' janë përmbledhur dhe ndarë në një tregues të përzier - Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve, për të matur ndryshimet në shtatë shtetet e Ballkanit Perëndimor me kalimin e kohës. Bazuar në provat hulumtuese, nëntë anëtarë të Panelit Këshillues në secilin shtet¹ vlerësojnë situatën dhe japin pike (rezultate) për secilin nga 19 treguesit brenda dimensioneve të mëposhtme:

- (1) **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistencën dhe zbatimin e masave mbrojtëse ligjore që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve;
- (2) **Parandalimi i duhur** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve;
- (3) **Procesi i rregullt** – sjelljen e institucioneve shtetërore dhe zyrtarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve;
- (4) **Siguria aktuale** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

ISG-BP u zhvillua bashkërisht nga studiuesit e Institutit RESIS² me bazë në Shkup dhe partnerët e platformës Safejournalists.net: Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Serbisë, Shoqata e

¹ Në Kosovë, Paneli Këshillues përbëhej nga: Imer Mushkolaj, Naile Dema, Labinot Leposhtica, Albioneta Ademi, Lavdim Makshana, Brikenda Rexhepi, Naim Sadiku, Valdete Osmani, Granit Musliu.


² Studiuesit e Institutit RESIS (www.resis.mk), Snezhana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Toševa kanë zhvilluar kornizën konceptuale për indeksin dhe modelin e grumbullimit të të dhënave, peshimit dhe llogaritjes së tij.

Gazetarëve të BeH-së, Sindikata e Mediave të Malit të Zi, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Shoqata e Gazetarëve Kroatë dhe studiues të pavarur në Shqipëri³. Si i tillë, Indeksi është rezultat i një pune të përbashkët të Platformës Safejournalists.net dhe mbulon të gjitha çështjet specifike që partnerët lokalë i identifikuan si të rëndësishme për kontekstin e vendit të tyre.

Viti i parë (pilot) për zhvillimin e kornizës konceptuale dhe metodologjisë për vlerësimin me pikë, grumbullimin e të dhënave dhe llogaritjen e Indeksit ishte viti 2020. Ky raport i referohet situatës në [vendi] në vitin 2021 dhe paraqet përmirësimet apo përkeqësimin e situatës lidhur me katër dimensionet përkatëse duke marrë parasysh vlerësimin për vitin 2020 si vit reference. Më shumë detaje rreth kornizës teorike dhe procedurës së ndërtimit dhe llogaritjes së ISG-BP dhe të gjitha raportet vendore mund t'i gjeni në: (<https://safejournalists.net/safety-index/>).

3 Blerjana Bino si studiuese e pavarur në Shqipëri për platformën Safejournalists.net.

INDEKSI I SIGURISË SË GAZETARËVE



| | 2020 | 2021 | | Zhvillimet në çdo dimension |
|---|-------------|-------------|----------|--|
| I. Mjedisi ligjor dhe organizativ | 3,86 | 3,69 | ↓ | Situata në vitin 2021 mbetet pothuajse e njëjtë si në të kaluarën, por rënia e lehtë e këtij dimension vjen si pasojë e faktit se ndërhyrja e policisë në punën e gazetarëve ka qenë më e shpeshtë se më parë. Për më tepër, kushtet e tyre të punës brenda redaksisë mbeten të njëjta, situata me pagat, sigurimet shëndetësore, orët e gjata të punës dhe pagesat me para në dorë, as këto nuk kanë ndryshuar shumë. |
| II. Parandalimi i duhur | 3,56 | 3,49 | ↓ | Ka një rënie të lehtë në këtë dimension sepse ishin dy raste kur gazetarët u penguan në detyrë nga Policia dhe një rast nga Prokuroria. Në përgjithësi, Policia e respekton profesionin e gazetarëve dhe tenton të mos i pengojë në punën e tyre. |
| III. Procesi i rregullt | 3,35 | 3,27 | ↓ | Mjeti i ndarjes së të dhënave ende nuk është krijuar në gjykata dhe këto të fundit nuk mund të japin asnjë statistikë për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. |
| IV. Siguria aktuale | 3,22 | 3,01 | ↓ | Në krahasim me vitin paraprak, ku në AGK janë raportuar 24 raste, situata është përkeqësuar dhe numri i sulmeve është rritur në 29 raste, e përveç rritjes së numrit të sulmeve, gjendja është përkeqësuar edhe për sa i përket llojit të sulmeve gjithashtu. |
| Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve | 3,39 | 3,24 | ↓ | |

— PËRMBLEDHJE

I. MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

- Duke qenë se gjykatat deri më sot kanë dështuar në mbledhjen e të dhënave dhe zbatimi i plotë i kornizës ligjore mediatik është ende një sfidë, situata mbetet e njëjtë. Për më tepër, korniza ligjore e mediave në Kosovë perceptohet si e drejtë, madje e krahasueshme me ato të vendeve me demokraci të avancuar. Një problem që vazhdon ndër vite dhe paraqet pengesë serioze për të vlerësuar objektivisht situatën në lidhje me këtë tregues është fakti se gjykatat ende nuk japin të dhëna për numrin e lëndëve për shpifje ndaj gazetarëve dhe shoqata e gazetarëve duhet ta mbledhë këto të dhëna nëpërmjet kanaleve të tjera, si organizatat, menaxherët e mediave dhe vetë gazetarët.

- Në vitin 2021, situata është përkeqësuar pak në krahasim me një vit më parë. Arsyeja është se gazetarët janë marrë në pyetje nga policia dhe prokuroria në dy raste, ndonëse ndaj tyre nuk është shqiptuar asnjë sanksion. Përndryshe, dispozitat e ligjeve në fuqi në Kosovë ofrojnë mbrojtje të mirë për burimet e gazetarëve. Gazetarët hulumtues që punojnë me temat e korrupsionit dhe krimin nuk ndihen të dekurajuar apo të frikësuar për t'i mbuluar ato.
- Situata në vitin 2021 është rënduar në krahasim me një vit më parë sa i përket zbatimit arbitrar të ligjeve të tjera. Sidomos përfshirja e prokurorisë në dy raste që kanë të bëjnë me gazetarët vlerësohet si shqetësuese dhe kontribuuese në destabilizimin e kushteve të punës së gazetarëve dhe sigurisë së tyre. Për më tepër, numri i SLAPP-ve ka ndikuar në përkeqësimin e situatës, si dhe në uljen e sigurisë së gazetarëve. Në Kosovë nuk ka asnjë mekanizëm që i mbron gazetarët nga paditë SLAPP dhe gjatë vitit 2021 gazetarët në Kosovë janë përballur me dhjetëra padi SLAPP. Vlerësohet se ka më shumë padi SLAPP për të cilat gazetarët ende nuk janë informuar. Këto të dhëna nuk janë të qasshme drejtpërdrejt në gjykata dhe Shoqata i mbledh këto të dhëna nga organizatat partnere.
- Situata mbetet pothuajse e njëjtë si në të kaluarën. Megjithatë, ndërhyrja e policisë në punën e gazetarëve ka qenë më e shpeshtë se më parë. Gjatë bllokimeve të vendosura për shkak të pandemisë, disa gazetarë kanë hasur në pengesa. Gazetarëve nuk u kërkohet të jenë të licencuar dhe as nuk kërkohet një licencë e tillë nga autoritetet shtetërore. Ata janë të lirë të formojnë dhe të anëtarësohen në shoqata; asnjë presion për ta bërë këtë nuk është regjistruar. Megjithatë, presioni për të luajtur rolin e një sindikate bie mbi AGK-në sa herë që shkelen të drejtat e punës ndaj punëtorëve të mediave. Edhe në të kaluarën AGK-ja ka reaguar për punëtorët e PSB-së, edhe pse në kuadër të saj janë tri sindikata.
- Në përgjithësi kushtet e punës së gazetarëve gjatë vitit 2021 mbeten të njëjta si në vitin 2020. Edhe pse janë krijuar media të reja dhe gazetarët kanë ndërruar vendet e tyre të punës, për atë që vlerësohet si kushte më të mira pune dhe trajtim brenda redaksive, situata me pagat, sigurimet shëndetësore, orarin e zgjatur të punës dhe pagesat me para në dorë mbetet e njëjtë. Gazetarët kanë frikë të ngritin padi për ngacmimet apo shkelje të të drejtave brenda vendit të punës, gjë që mbetet një nga sfidat më të mëdha. Nga ana tjetër, vetëm gjatë vitit 2021 në AGK janë anëtarësuar mbi 300 gazetarë. Për më tepër, AGK ka mundur t'u ofrojë anëtarëve të saj përfaqësim ligjor falas, edhe pse kjo ndihmë nuk është kërkuar gjatë vitit raportues.

II. PARANDALIMI I DUHUR

- Në krahasim me vitin 2020 situata është pothuajse e njëjtë. Situata perceptohet të jetë rënduar në disa nuanca për sa i përket sigurisë së gazetarëve, duke pasur parasysh se një nga rastet e ndodhura gjatë vitit përkatës, ai i sulmit fizik ndaj Visar Duriqit, është ende nën hetim. Ashtu si në të kaluarën nuk ka persona kontaktues apo numra të posaçëm për gazetarët për të raportuar rastet e tyre brenda institucioneve dhe gazetarët raportojnë rastet e tyre në të njëjtën mënyrë si çdo qytetar tjetër. Edhe pse nuk dihen dhe as raportohen raste ku institucionet përkatëse nuk janë përgjigjur fare, as përpunojnë apo pranojnë raportim të gazetarëve apo mediave për shkeljen e të drejtave të tyre, ka shumë raste të pazgjidhura nga viti 2021 dhe vitet e mëparshme (Rasti i Shkumbin Kajtazit në 2020; Rasti i Visar Duriqit 2021). PK-ja perceptohet si institucioni më efikas, ndërsa gjykatat më pak bashkëpunuese dhe efektive, për shkak të zvarritjes së rasteve apo moszgjidhjes fare të tyre.
- Gjatë vitit 2021, gjendja sa i përket mbrojtjes së gazetarëve me ligjet përkatëse mbetet pothuajse e njëjtë me një vit më parë; megjithatë, perceptohet si një ndryshim pozitiv që organizatat që veprojnë në Kosovë kanë treguar më shumë interes për përfaqësimin ligjor të gazetarëve (pa pagesë). Gjatë vitit 2021 OSBE-ja i ofroi AGK-së një avokat i cili do të përfaqësonte Asociacionin si dhe gazetarët në procedurat ligjore. Për më tepër, dispozitat ligjore, si Kodi Penal i Republikës së Kosovës që mbrojnë çdo person që mund të jetë viktimë e veprave penale për shkak të punës së tij/saj mbrojnë edhe gazetarët, por nuk ka dispozita ligjore që mbrojnë gazetarët më shumë se sa qytetarët e tjerë. Procedura e vlerësimit të rrezikut nuk është e përcaktuar qartë. Megjithatë, nëse policia vlerëson se siguria e gazetarëve është e rrezikuar, mund t'u japë atyre mbrojtje policore.
- Ngjashëm me vitin 2020, në vitin 2021 janë raportuar në AGK 3 raste të sulmeve, kërcënimeve dhe ngacmimeve ndaj grave gazetare. Këto raste të sulmeve verbale duhej të raportoheshin vetëm në AGK. Megjithatë, grave gazetare nuk u ofrohet asistencë shtesë nga institucionet përkatëse në raport me kolegët e tyre meshkuj apo qytetare të tjera femra.
- Vlerësohet si pozitive që diskriminimi me bazë gjinore nuk ndodh brenda institucioneve të sundimit të ligjit, megjithatë llojet e sulmeve ndaj gazetareve femra nxjerrin në pah diskriminimin me bazë gjinore, sepse kryesit e këtyre veprave përdorin forma të ndryshme presioni dhe gjuhe ndaj gazetareve femra.
- Numri i sulmeve online nga politikanë dhe zyrtarë të lartë është rritur me pesë në krahasim me vitin 2020 dhe kjo rritje është tregues i rrezikshmërisë dhe jostabilitetit të

profesionit të gazetarit, si dhe lirisë së medias. Rastet më të shpeshta të kërcënimeve vijnë nga persona që duhet të mbrojnë të drejtat e gazetarëve dhe të promovojnë lirinë e shprehjes, rrjedhimisht edhe median. Ka hipokrizi në sjelljen e politikanëve për faktin se janë kryesisht ata që përdorin gjuhë poshtëruese ndaj gazetarëve dhe kjo gjuhë zakonisht çon në më shumë kërcënime dhe linçime nga ndjekësit e tyre, veçanërisht në internet.

- Situata u rëndua në vitin 2021 më së shumti për shkak të masave të zgjatura në lidhje me pandeminë. Ka pasur dy raste kur gazetarët janë penguar në detyrë nga Policia dhe një rast nga Prokuroria. Në përgjithësi, policia respekton profesionin e gazetarëve dhe priret të mos i pengojë ata të bëjnë punën e tyre. Për më tepër, PK-ja mbetet institucioni më efektiv dhe bashkëpunues me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës.

III. PROCESI I RREGULLT

- Gjatë vitit 2021 nuk është bërë asnjë ndryshim sa u përket hetimeve dhe ndjekjeve të specializuara të akteve të dhunës ndaj gazetarëve. Situata mbetet e njëjtë si në vitet paraprake. Sipas praktikave, policia dhe prokuroria nuk kanë profesionalizmin dhe ekspertizën e duhur në lidhje me masat mbrojtëse ligjore në fuqi të parapara me legjislacionin në fuqi në Kosovë, pasi nuk ka udhëzime apo politika të miratuara as nga sistemi prokurorial dhe as nga Policia për trajtimin e rasteve kundër gazetarëve. Krahas emërimit të një koordinatori nga PK-ja dhe Prokuroria, gjykatat kanë caktuar edhe koordinatorë të cilët merren edhe me rastet e kërcënimeve, sulmeve dhe ngacmimeve ndaj gazetarëve.
- Situata sa i përket këtij treguesi nuk është përmirësuar gjatë vitit 2021. Efikasiteti me të cilin hetimet në rastet kur përfshihen gazetarë nuk është përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme. Gazetarët vazhdojnë të përballen me zvarritje të lëndëve nga gjykatat, ndërsa këto procedura mbeten të patrajtuara me prioritet. Për më tepër, në përgjithësi, sistemi i drejtësisë është i ngadaltë dhe joefektiv dhe disa raste të sulmeve ndaj gazetarëve mbeten të pandëshkuar. Herë pas here, sulmet ndaj gazetarëve nuk konsiderohen si vepra penale, duke i detyruar gazetarët të bëjnë padi private në vend që të ndiqen sipas detyrës zyrtare. OShC-të dhe media, së bashku me Shoqatën e Gazetarëve, janë ato që iniciojnë reagimin e publikut. Procedurat gjyqësore mbeten problematike, duke qenë se nuk trajtohen me prioritet nga gjykatat, ndërsa reagimi i Policisë dhe Prokurorisë vjen menjëherë pas sulmit.
- Situata në lidhje me sigurinë e gazetarëve është përkeqësuar gjatë vitit 2021. Edhe pse reagimi i policisë në të shumtën e rasteve ka qenë i menjëhershëm, problematik është fakti që deri më sot nuk ka dispozita në

ligjet në fuqi që njohin ngacmimin online ndaj gazetarëve, kur ata janë viktime të një krimi të tillë, duke pasur parasysh se gazetarët janë caqe të veçanta të këtij lloji ngacmimesh në krahasim me profesionistët e tjerë. Gjatë vitit 2021 gazetarët në Kosovë u vunë në shënjestër të dhjetë sulmeve online, frikësimeve, kërcënimeve dhe fyerjeve, veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore. Si pasojë e reagimit të ngadaltë dhe mungesës së efikasitetit të institucioneve të drejtësisë në trajtimin e lëndëve penale dhe civile ndaj gazetarëve, masat ligjore ishin pothuajse joefektive. Zakonisht ofendimet dhe gjuha denigruese vijnë nga zyrtarë të lartë dhe persona me ndikim. Reagimi i shpejtë i PK-së në rastet e Vehbi Kajtazit, G.G. dhe Sh.K. konsiderohen përmirësim nga vitet e kaluara; megjithatë, sistemi i drejtësisë ka ende një rrugë të gjatë në vendosjen e dispozitave specifike kur bëhet fjalë për ngacmimin online kundër gazetarëve.

- Në lidhje me procedurat hetimore dhe procedurat gjyqësore nuk u identifikua asnjë progres apo përqendrim gjatë vitit 2021. Për shkak të faktit se SMIL (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve) nuk është krijuar edhe gjatë vitit 2021, gjykatat nuk arrijnë të ofrojnë informacionin e nevojshëm në lidhje me lëndët duke përfshirë edhe gazetarët. Ndërkohë, që nga tendenca për të rishikuar Kodin e Sjelljes në vitet 2019-2020, që do të kufizonte mundësinë e gazetarëve për të raportuar nga seancat gjyqësore, nuk ka pasur asnjë tentativë tjetër si të tillë. Megjithatë, vlerësohet se transparencja në mënyrën se si zhvillohen procedurat gjyqësore për sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave nuk është e kënaqshme.
- Situata në Kosovë mbetet pothuajse e njëjtë. Megjithatë, është shqetësues fakti se mjeti i ndarjes së të dhënave nuk është krijuar ende në gjykata dhe këto të fundit nuk mund të japin asnjë statistikë për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Është e një rëndësie të madhe që SMIL të funksionalizohet, sepse do të konsolidonte të dhënat dhe statistikën jo vetëm që kanë të bëjnë me gazetarin por edhe për të gjitha lëndët penale dhe civile në gjyqësor. Është gjithashtu e rëndësishme që sistemi informativ i menaxhimit të lëndëve të jetë i ndërlidhur me sistemin informativ të Policisë së Kosovës në mënyrë që të rritet komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe prokurorisë në trajtimin e rasteve kundër gazetarëve.

IV. SIGURIA AKTUALE

- Në krahasim me vitin paraprak, ku janë raportuar 11 raste në AGK, gjendja është përqendësuar, përveç rritjes së numrit të sulmeve, është përqendësuar edhe në llojin e sulmeve. Kërcënimet dhe sulmet ndryshojnë nga ato të zyrtarëve të lartë ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të mediave, tek ato të institucioneve të sundimit të ligjit, si dhe zyrtarëve të lartë të partive politike. Prokuroria ka

qenë e përfshirë në dy nga trembëdhjetë rastet, edhe pse AGK-ja ka kërkuar nga Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës që t'u bëjë thirrje prokurorëve që të respektojnë Kushtetutën dhe të veprojnë në përputhje me ligjin.

- Siguria e gazetarëve është rënduar gjatë vitit raportues, në krahasim me vitet e mëparshme. Ndërsa në vitin 2020 ka pasur gjashtë raste në vitin 2021 janë dhjetë raste të kërcënimit të jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve. Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve janë bërë kryesisht përmes mediave sociale, përmes mesazheve private apo postimeve publike.
- Numri i sulmeve aktuale ndaj gazetarëve është ulur me një në vitin 2021. Megjithatë, llojet e incidenteve përfshinin një nga sulmet fizike më të ashpra të regjistruara ndonjëherë në bazën e të dhënave të AGK-së. Rasti i Visar Duriqit mbetet nën hetim dhe asnjë nga autorët nuk është vënë para drejtësisë.
- Situata dhe numri i rasteve të raportuara në AGK gjatë vitit paraprak ishte gjithashtu tre. Megjithatë, rastet e vitit 2021 përfshinin zyrtarë nga tri parti kryesore politike. Prandaj, vlerësimi i përgjithshëm i AGK-së është se situata në vitin 2021 është përkeqësuar pak në krahasim me vitin paraprak.

Mjedisi Ligjor dhe Organizativ

3,69



10

Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk prodhojnë efekte dekurajuese për gazetarët dhe mediat

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,50 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,50**

Duke qenë se gjykatat deri më sot kanë dështuar në mbledhjen e të dhënave dhe zbatimi i plotë i kornizës ligjore mediatik është ende një sfidë, situata mbetet e njëjtë. Për më tepër, korniza ligjore e mediave në Kosovë perceptohet si e drejtë, madje e krahasueshme me ato të vendeve me demokraci të avancuar. Një problem që vazhdon ndër vite dhe paraqet pengesë serioze për të vlerësuar objektivisht situatën në lidhje me këtë tregues është fakti se gjykatat ende nuk japin të dhëna për numrin e lëndëve për shpifje ndaj gazetarëve dhe shoqata e gazetarëve duhet ta mbledhë këto të dhëna nëpërmjet kanaleve të tjera, si organizatat, menaxherët e mediave dhe vetë gazetarët.

Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes përcakton përgjegjësinë civile ndaj qytetarëve ose gazetarëve kur ka padi për shpifje ose fyerje. Korniza ligjore në Kosovë ka dekriminalizuar fyerjet. Kështu, gazetarët nuk mund t'i nënshtrohen hetimit penal për artikujt, raportet apo opinionet e tyre.

Ligji për aspektet civile kundër shpifjes dhe fyerjes është krijuar për t'u zbatuar dhe interpretuar në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si garanci për promovimin e lirisë së shprehjes dhe mendimit. Megjithatë, mungesa e njohurive dhe ekspertizës nga ana e gjyqtarëve për zbatimin e praktikave të KEDNJ-së përbën pengesë për promovimin e të drejtave të gazetarëve dhe mediave në Kosovë.

Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes nuk parasheh sanksione, ligji parasheh detyrimin për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga të pandehurit me shpifje dhe fyerje. Shpërblimi që caktohet nga gjykata duhet të jetë në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar dhe do të përcaktohet vetëm për të korrigjuar dëmin e shkaktuar në reputacionin e personit në fjalë, ose për të kompensuar çdo humbje të mundshme financiare ose dëm material.

Zyrtarët publikë mund të paraqesin dëmshpërblim për shpifje ose fyerje privatisht dhe ekskluzivisht në cilësinë e tyre personale. Megjithatë, zyrtarët shtetërorë kanë të drejtë të ngrenë padi civile. Ka pasur disa aktakuza SLAPP të cilat janë ngritur në një rast ku kompania ndërkombëtare që operon në Kosovë ka ngritur padi kundër aktivistit qytetar të Kosovës, dhe raste të tjera kanë qenë kur politikanët kanë ngritur aktakuza SLAPP kundër gazetarëve që kanë raportuar apo ekspozuar gabimet e tyre. Një problem që ndikon seriozisht situatën në këtë tregues është fakti se gjykatat nuk kanë të dhëna për numrin e procedurave për shpifje ndaj gazetarëve dhe shoqata e gazetarëve duhet t'i mbledhë këto të dhëna përmes kanaleve të ndryshme, si organizata partnere, media dhe/ose vetë gazetarët. Sipas të dhënave të AGK-së të mbledhura nga intervistat e thelluara me menaxherët e mediave dhe gazetarët, gjatë vitit 2021 nuk ka asnjë rast në të cilin paditësi ka qenë politikan me ndikim, megjithatë SLAPP-të ndaj gazetarëve dhe aktivistëve janë iniciuar nga aktorë të fuqishëm të korporatave.

Çështjet gjyqësore mund të jenë deri diku të motivuara politikisht sipas disa ekspertëve të mediave; megjithatë, asnjë rast nuk është regjistruar gjatë vitit 2021. Mungesa e njohurive dhe ekspertizës nga ana e gjyqtarëve për zbatimin e praktikave të KEDNJ-së përbën pengesë për promovimin e të drejtave të gazetarëve dhe mediave në Kosovë. Për më tepër, vlerësohet se edhe pse gjykatave dhe gjyqtarëve u ofrohen trajnime adekuate nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të së drejtës mediatike, ata nuk arrijnë t'i përqafojnë ato praktika. Nga këta të fundit perceptohet kryesisht si mungesë e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës brenda institucioneve, ndërsa komuniteti gazetaresk druan se kjo ndodh nga neglizhenca e organit përkatës.

Sipas përgjigjeve të gazetarëve në fokus grupe, si dhe në një anketë të bërë nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, ligji për shpifje nuk konsiderohet dekurajues. Gazetarët hulumtues ndjehen të lirë të hetojnë dhe të shkruajnë në mënyrë kritike. Për më tepër, gazetarët nuk vetë-censurohen për shkak të ligjeve në fuqi.

Ndërsa praktika e gjykatave për dënimin me gjobë ose me kusht të atyre që kryejnë vepra penale ndaj gazetarëve, ka ndikim shumë të fortë negativ ndaj gazetarëve, gjithashtu një qasje e tillë nga autorët e mundshëm konsiderohet shumë inkurajuese për kryerjen e veprave të tilla në të ardhmen.

Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet

**Vlerësimi për vitin 2020: 4,87 /
Vlerësimi për vitin 2021: 4,61**

Në vitin 2021, situata është përkeqësuar pak në krahasim me një vit më parë. Arsyeja është se gazetarët janë marrë në pyetje nga policia dhe prokuroria në dy raste, ndonëse ndaj tyre nuk është shqiptuar asnjë sanksion. Përndryshe, dispozitat e ligjeve në fuqi në Kosovë ofrojnë mbrojtje të mirë për burimet e gazetarëve. Gazetarët hulumtues që punojnë me temat e korrupsionit dhe krimit nuk ndihen të dekurajuar apo të frikësuar për t'i mbuluar ato.

Legjislacioni në Kosovë garanton mbrojtjen e burimeve anonime gazetareske dhe profesionistëve të tjerë të medias. Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias janë të detyruar të zbulojnë identitetin e burimit të informacionit vetëm me kërkesë të gjykatës kompetente dhe vetëm në rastet kur zbulimi i burimit është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim serioz të integritetit fizik që rezulton me vdekjen e një ose më shumë njerëzve. Në Kosovë është në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Burimeve Gazetare, i cili ka ndërtuar standardet dhe sigurinë për gazetarët, duke kufizuar detyrimin e tyre për të zbuluar burime anonime vetëm me vendim gjykate. Ky ligj ka kufizuar të drejtën e policisë, prokurorisë apo institucioneve tjera të zbatimit të ligjit në Kosovë për të kërkuar zbulimin e burimeve anonime të gazetarëve, pa një vendim të lëshuar nga gjykata kompetente.

Gazetarët nuk kanë asnjë detyrim t'i përgjigjen ftesës së policisë apo prokurorisë për të folur për burimet e informacionit. Gjithashtu, gazetarët nuk kanë asnjë detyrim të japin deklaratë në polici apo prokurori në lidhje me artikujt apo raportet e publikuara, me përjashtim të rastit kur ka vendim me shkrim nga gjykata kompetente, për parandalimin e veprave penale që si pasojë mund të cenojnë integritetin fizik, me pasojë vdekjen e një apo më shumë personave. Dy raste që kanë ndodhur në vitin 2021 kanë të bëjnë me prokurorë që nuk kanë respektuar protokollin ose kanë vepruar në përputhje me ligjet në fuqi. Gazetari Mentor Gjergjaj është thirrur për t'u marrë në pyetje në Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe gazetari Parim Olluri është marrë në pyetje në Prishtinë. Nuk janë shqiptuar sanksione lidhur me rastet e lartpërmendura dhe AGK-ja ka

kërkuar nga Kryeprokurori i Shtetit që t'u bëjë thirrje të gjithë prokurorëve që të respektojnë ligjet në fuqi në Kosovë.

Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur raste të reja ku gazetarët janë urdhëruar nga autoritetet shtetërore të dorëzojnë pajisjet e tyre (kompjuterin, celularin etj.) dhe në këtë mënyrë të bëjnë të ditur burimet e tyre. Rasti i fundit i njohur si i tillë është i vitit 2018. Gazetarja e Koha Ditore, Saranda Ramaj, më 28 dhjetor 2018, është nxjerrë nga gjykatorja për rastin e organizatës "Syri i Popullit", derisa po dëshmonte presidenti i vendit, Hashim Thaçi. Telefoni i saj është marrë nga njësi policore për mbrojtje të afërt të presidentit Thaçi. Saranda Ramaj është mbajtur për 6 orë në polici dhe i kanë mbajtur telefonin për disa orë me arsyetimin se kishte regjistruar në mënyrë të jashtëligjshme deklaratën e presidentit Hashim Thaçi në seancën gjyqësore "Syri i Popullit". Për këtë rast kanë reaguuar Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Organizata Mediale e Evropës Juglindore dhe Instituti i Drejtësisë së Kosovës.

Në Kosovë, gazetarët hulumtues që mbulojnë temat e korrupsionit dhe krimin nuk ndjehen të dekurajuar apo të frikësuar për të trajtuar temat e tyre. Sipas përgjigjeve të gazetarëve në fokus grupe, si dhe në anketën e bërë nga AGK-ja, ata ndjehen të lirë të kërkojnë qasje dhe të mbajnë kontakte me burimet e tyre të informacionit.

Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe u mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,62 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,14**

Situata në vitin 2021 është rënduar në krahasim me një vit më parë sa i përket zbatimit arbitrar të ligjeve të tjera. Sidomos përfshirja e prokurorisë në dy raste që kanë të bëjnë me gazetarët vlerësohet si shqetësuese dhe kontribuuese në destabilizimin e kushteve të punës së gazetarëve dhe sigurisë së tyre. Për më tepër, numri i SLAPP-ve ka ndikuar në përkeqësimin e situatës, si dhe në uljen e sigurisë së gazetarëve. Në Kosovë nuk ka asnjë mekanizëm që i mbron gazetarët nga paditë SLAPP dhe gjatë vitit 2021 gazetarët në Kosovë janë përballur me dhjetëra padi SLAPP. Vlerësohet se ka më shumë padi SLAPP për të cilat gazetarët ende nuk janë informuar. Këto të dhëna nuk janë të qasshme drejtpërdrejt në gjykata dhe Shoqata i mbledh këto të dhëna nga organizatat partnere.

Në krahasim me vitin 2020, ku janë raportuar të paktën dy raste ku gazetarët kanë qenë subjekt i zbatimit arbitrar nga institucionet e sigurisë apo drejtësisë si rezultat i raportimit të tyre, gjatë vitit 2021 numri është rritur për një. Gjatë periudhës raportuese kanë ndodhur tri raste të pengimit gjatë kryerjes së detyrës. Rasti i parë ka ndodhur në prill të vitit 2021, ku kryeredaktori dhe gazetari i Insajderit, Parim Olluri është marrë në pyetje nga Policia e Kosovës, pasi Gazeta Insajderi kishte publikuar një hetim që përmban informacione të brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë. Rasti i dytë ka ndodhur në nëntor të vitit 2021, pasi dy ekipe televizive, ai i TV Dukagjinit, si dhe i Klan Kosovës, të cilët kanë shkuar në vendngjarje për të raportuar drejtpërdrejt për grabitjen e armatosur në qarqet Prishtinë-Gjilan, janë penguar dhe gjobitur nga Policia e Kosovës; rruga ishte lejuar të përdoret nga qytetarët e tjerë, por jo nga këto grupe televizive. Rasti i fundit ka ndodhur në fund të vitit, gazetari dhe redaktori i portalit "Indeksonline", Alban Muhaxheri është marrë në pyetje për disa orë në Stacionin Policor në Kaçanik, pasi kishte shkruar për një pjesëtar të Policisë në një

faqe lokale në Facebook. Megjithatë, nuk ka raste që gazetarëve t'u refuzohet e drejta për të raportuar nga një ngjarje e caktuar me arsyetimin se nuk kanë akreditim gjatë vitit 2021. Nuk ka tendencë për të krijuar legjislacion përmes të cilit ata do të heshtnin, kërcënonin apo frikësonin gazetarët. Megjithatë, nuk ka asnjë mekanizëm që i mbron gazetarët nga paditë SLAPP dhe as Agjencia për Ndhimë Juridike Falas si agjenci publike e ndihmës juridike, nuk i kategorizon gazetarët si përfitues të ndihmës juridike në rastet kur përballen me paditë SLAPP.

Dhjetëra padi SLAPP që janë ngritur në vitin 2021 kundër gazetarëve hulumtues si dhe aktivistëve publikë në Kosovë, duke u përballur me akuza për shpifje. Nëpërmjet këtyre padive është kërkuar dëmshpërblimi i dëmit material dhe moral nga gazetarët. Hetimet e gazetarëve ndaj aferave të ndryshme të jashtëligjshme të kompanive, nga këto të fundit janë cilësuar si shpifje, ku përmes padive SLAPP është kërkuar dëmshpërblim për dëmin moral dhe material. Ligji për aspektet civile kundër shpifjes dhe fyerjes përcakton se vetë ligji duhet të zbatohet në përputhje me praktikën e KEDNJ-së. Përveç këtij ligji, Kosova nuk ka legjislacion shtesë për të ofruar siguri juridike për gazetarët kur ata janë subjekt i padive SLAPP. Pasojat negative për gazetarët në rastin e padive SLAPP janë koha e kaluar e gazetarëve në seancat gjyqësore, si dhe shpenzimi i mjeteve materiale për përfaqësim juridik në rastet e trajtimit gjyqësor të këtyre padive.

Sipas të dhënave të mbledhura nga intervistat e thelluara me gazetarët, si dhe nga fokus grupet, siguria e gazetarëve nuk rrezikohet më shumë në situatat kur gazetarët raportojnë nga protestat. Nga gazetarët kërkohet që t'i mbajnë në vend të dukshëm dokumentet e tyre të identifikimit, në mënyrë që të identifikohen nga Policia ose zyrtarë të tjerë. Gjatë vitit 2021 u organizua një trazirë në veri të Kosovës, ku ndodhën tri raste të sulmeve. Në rastin e parë të gjithë gazetarët që raportonin nga protesta u sulmuan nga protestuesit dhe në rastin e dytë ishte ekipi i televizionit Kanal 10, ku gazetarja Albulena Rexha u godit me mjete piroteknike gjatë raportimit live. Rasti i fundit nuk ka ndodhur në protestë, por disa protestues kanë demoluar taksinë e ekipit të Radios Evropa e Lirë dhe kanë dëmtuar kamerën.

Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, anëtarësohen dhe marrin pjesë në shoqatat e tyre

**Vlerësimi për vitin 2020: 4,11 /
Vlerësimi për vitin 2021: 4,01**

Situata mbetet pothuajse e njëjtë si në të kaluarën. Megjithatë, ndërhyrja e policisë në punën e gazetarëve ka qenë më e shpeshtë se më parë. Gjatë bllokimeve të vendosura për shkak të pandemisë, disa gazetarë kanë hasur në pengesa. Gazetarëve nuk u kërkohet të jenë të licencuar dhe as nuk kërkohet një licencë e tillë nga autoritetet shtetërore. Ata janë të lirë të formojnë dhe të anëtarësohen në shoqata; asnjë presion për ta bërë këtë nuk është regjistruar. Megjithatë, presioni për të luajtur rolin e një sindikate bie mbi AGK-në sa herë që shkelen të drejtat e punës ndaj punëtorëve të mediave. Edhe në të kaluarën AGK-ja ka reaguar për punëtorët e TSHP-së, edhe pse në kuadër të saj janë tri sindikata.

Në Kosovë, gazetarët nuk janë të detyruar të licencohen nga shteti për të ushtruar profesionin e tyre dhe organet shtetërore nuk kanë tentuar t'i licencojnë ata gjatë periudhës raportuese. Gjatë bllokadave të vendosura për shkak të pandemisë në vitin 2021, disa gazetarë janë penguar gjatë kryerjes së detyrave të tyre: Rasti i parë ka ndodhur në prill të vitit 2021, ku kryeredaktori dhe gazetari i Insajderit, Parim Olluri është marrë në pyetje nga Policia e Kosovës, pasi Gazeta Insajderi kishte publikuar një hetim që përmban informacione të brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë. Rasti i dytë ka ndodhur në nëntor të vitit 2021, pasi dy ekipe televizive, ai i TV Dukagjinit, si dhe i Klan Kosovës, të cilët kanë shkuar në vendngjarje për të raportuar drejtpërdrejt për grabitjen e armatosur në qarqet Prishtinë-Gjilan, janë penguar dhe gjobitur nga Policia e Kosovës; rruga ishte lejuar të përdoret nga qytetarët e tjerë, por jo nga këto ekipe televizive. Rasti i fundit ka ndodhur në fund të vitit, gazetari dhe redaktori i portalit "Indeksonline", Alban Muhaxheri është marrë në pyetje për disa orë në Stacionin Policor në Kaçanik, pasi kishte shkruar për një pjesëtar të Policisë në një faqe lokale në Facebook. Megjithatë, nuk ka raste që gazetarëve t'u refuzohet e drejta për të raportuar nga një ngjarje e caktuar me arsyetimin se nuk kanë akreditim gjatë vitit 2021. Në përgjithësi, gazetarët njihen në procedurat përkatëse para autoriteteve publike; megjithatë, AGK-ja dhe PK-ja vazhdimisht

u bëjnë thirrje të gjithë punëtorëve të mediave që të kenë gjithmonë dokumentet identifikuese gjatë kryerjes së detyrave të tyre, veçanërisht në protesta, trazira dhe kur raportojnë për/nga institucionet. Gazetarëve u garantohet e drejta e asociimit dhe liria për të formuar sindikata. Ato përfaqësohen nga dy shoqata, AGK dhe AGKS, por aktualisht janë vetëm tri sindikata brenda PSB-së. Nuk ka asnjë sindikatë që përfaqëson interesat e të gjithë gazetarëve në Kosovë apo mbron të drejtat e tyre të punës, prandaj AGK-ja shërben si organizata kryesore avokuese për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.

Gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur presion e as pengesa që gazetarët t'i bashkohen organizatave që përfaqësojnë interesat e tyre. Gjatë vitit 2021 AGK-së i janë bashkuar mbi 300 anëtarë të rinj. As AGK-ja dhe as komuniteti i gazetarëve nuk janë në dijeni për organizime mediatike paralele apo të rrejshme.

Pozita e punës e gazetarëve është e qëndrueshme dhe e mbrojtur në vendin e punës

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,20 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,20**

Në përgjithësi kushtet e punës së gazetarëve gjatë vitit 2021 mbeten të njëjta si në vitin 2020. Edhe pse janë krijuar media të reja dhe gazetarët kanë ndërruar vendet e tyre të punës, për atë që vlerësohet si kushte më të mira pune dhe trajtim brenda redaksive, situata me pagat, sigurimet shëndetësore, orarin e zgjatur të punës dhe pagesat me para në dorë mbetet e njëjtë. Gazetarët kanë frikë të ngritin padi për ngacmimet apo shkelje të të drejtave brenda vendit të punës, gjë që mbetet një nga sfidat më të mëdha. Nga ana tjetër, vetëm gjatë vitit 2021 në AGK janë anëtarësuar mbi 300 gazetarë. Për më tepër, AGK ka mundur t'u ofrojë anëtarëve të saj përfaqësim ligjor falas, edhe pse kjo ndihmë nuk është kërkuar gjatë vitit raportues.

Në Kosovë, gazetarët përballen me një gamë të gjerë sfidash lidhur me kontratat e tyre të punës, sigurimet shoqërore dhe pagat. Sipas një hulumtimi të bërë nga AGK-ja në vitin 2020, numri i gazetarëve me kontrata të nënshkruara është rritur në krahasim me vitet e kaluara. Në vitin 2021 nuk ka të dhëna të sakta se sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune, andaj Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka bërë një anketë në lidhje me kontratat dhe kushtet e punës së gazetarëve në punën e tyre. Të dhënat e mbledhura nga Shoqata tregojnë se numri i kontratave të nënshkruara është rritur me 15-20% në krahasim me vitin 2020, kjo për faktin se janë krijuar media të reja (dy kanale televizive) dhe gazetarët kanë ndërruar më shpesh vendin e punës, ndërsa në vitin paraprak qeveria i ka ofruar sektorit privat në Kosovë një Pako Emergjente gjatë pandemisë, e cila ka kontribuar në këtë rritje. Edhe pse pjesa më e madhe e pagave u ulën si pasojë e pandemisë, pati edhe ndërprerje të kontratave, orare të gjata pune pa kompensim, ndryshim të kushteve dhe kontratave të punës nga puna me orar të plotë në punë me orar të shkurtuar dhe pushime të detyruara pa kompensim.

Pagat e shumicës së punonjësve të mediave janë vonuar, përveç transmetuesve publikë. Për më tepër, gazetarët në shumicën e mediave private përballen me sfidat më të mëdha në vendin e punës, sepse ata punojnë me orare të

gjata pa kompensim dhe nuk kanë sigurim shëndetësor. Për më tepër, sfida më e madhe nga të gjitha është paga e tyre, pasi një numër i madh gazetarësh pohojnë se punojnë me paga nën mesataren e vendit që është 480 euro, ndërsa paga minimale për vitin 2021 ishte 168 euro. Megjithatë, ata përballen me vonesa, në disa raste nuk paguhen rregullisht, madje paguhen me para në dorë (në disa raste edhe kesh edhe nëpërmjet bankës, në mënyrë të përzier). Vetëm gazetarët nga transmetuesi publik dhe disa nga punonjësit e mediave kryesore paguhen rregullisht. Për gazetarët e pavarur viti 2021 ka qenë mjaft sfidues.

Vitet e fundit, peizazhi mediatik i Kosovës është pasuruar me media të reja dhe ndryshime në pronësi dhe ekipe redaktuese. ATV është themeluar në shkurt të vitit 2021, ndërkohë që ka filluar punën një tjetër kanal televiziv. Gjatë vitit 2021 janë bërë shumë ndryshime në sektorin e mediave, ndërkohë që është vënë re se gazetarët kanë vazhduar të ndërrojnë vendet e tyre të punës. Mendohet se kjo ka të bëjë me faktin se mediat e sapohapura ofrojnë kushte më të mira se ato ekzistuese. Përveç gazetarëve, disa nga organet drejtuese të mediave (veçanërisht televizioni) ndërruan edhe kompaninë mediatike. Gazeta Express dhe T7, bashkëthemelues dhe drejtor, Berat Buzhala shiti aksionet e tij të të dyja kompanive mediatike, ndërsa Leonard Kërquki mori përgjegjësinë për menaxhimin e të dyja mediave.

Kushtet e punës së gazetarëve femra dhe meshkuj në redaksi janë kryesisht të njëjta. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e grave dhe burrave që kanë nënshkruar kontrata pune, por sipas disa vlerësimeve ka dukshëm më shumë gazetare femra në redaksi. Nuk ka statistika të kohëve të fundit për postet kryesore editoriale në redaksi, por gazetaret femra kanë më shumë gjasa të mbajnë poste editoriale në redaksi, veçanërisht në mediat kryesore, ndërsa gazetarët meshkuj janë më të ngarkuar me menaxhimin. Deri më tani, shumica e emisioneve televizive kryesore mediatike që transmetohen në kohën kryesore drejtohen nga gazetarë meshkuj. Është vlerësuar se kontratat nuk janë diskriminuese në baza gjinore, pasi pagat e të gjithë punonjësve të mediave bazohen në performancën e tyre dhe jo të ndara sipas gjinisë. AGK-ja ka realizuar dy anketa në vitin 2020 lidhur me kushtet e punëtorëve mediatik dhe sipas tyre pagat mesatare të gazetarëve variojnë nga 250 deri në 350 euro, po ashtu është konstatuar se pagat e grave gazetare janë të njëjta me pagat e kolegëve të tyre meshkuj. Kjo u rikonfirmua edhe në fokus grupet e zhvilluara në vitin 2021. Më parë është vlerësuar se presioni i bazuar në gjini është i pranishëm vetëm në rastet kur gratë gazetare janë shtatzënë dhe/ose kthehen në punë pas pushimit të lehonisë. Pas diskutimeve në fokus grupe me gazetaret femra gjatë periudhës së raportimit, ky presion nuk ishte aq i pranishëm në vitin 2021. Gjatë vitit 2021 ka pasur një rritje të interesimit të gazetarëve të pavarur për t'u anëtarësuar në AGK. Baza e të dhënave të organizatës përbëhet nga 26 gazetarë të pavarur; megjithatë, perceptohet se ky nuk është numri real i profesionistëve të lirë në Kosovë.

Kryesisht, gazetarët e pavarur në Kosovë punojnë për mediat ndërkombëtare si korrespondentë, ose organizata mediatike të themeluara në nivel kombëtar. Për shkak të pandemisë dhe masave për të parandaluar përhapjen e virusit, viti 2021 ka qenë mjaft sfidues për gazetarët e pavarur sa i përket funksionimit. Në kuadër të PSB-së ekzistojnë tri sindikata, por në Kosovë nuk ekziston një sindikatë gjithëpërfshirëse. Deri më tani nuk është lidhur asnjë marrëveshje kolektive, dhe të drejtat e të gjithë punonjësve të mediave janë të garantuara vetëm me Ligjin e Punës në fuqi në Kosovë. Mediat kryesore zakonisht kanë avokatët e tyre, ndërsa mediat më të vogla, me theks në mediat online, nuk mund të ofrojnë asnjë lloj mbrojtjeje për punëtorët e tyre. Prandaj, AGK-ja ka kërkuar nga OSBE-ja që t'i sigurojë organizatës një përfaqësues ligjor i cili do të jetë në gjendje të përfaqësojë të gjithë punëtorët e mediave në procedurat penale ose civile, të cilat kanë të bëjnë me profesionin e gazetarit. Në vitin 2019 AGK-ja nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Odën e Avokatëve të Kosovës për të ofruar mbrojtje ligjore falas për gazetarët, pasi që shumica dërrmuese e mediave nuk ofrojnë mbrojtje ligjore për punonjësit e tyre. OAK-ja në mënyrë të njëanshme e ndërpreu memorandumin me AGK-në në gusht të vitit 2020, duke i lënë gazetarët pa mbrojtje ligjore. Megjithatë, organizatat si IKD, KDI dhe avokatët e pavarur kanë ofruar shërbimet e tyre për gazetarët.



Parandalimi i duhur

3,49



22

Gazetarët dhe aktorët e mediave kanë qasje në masat mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive kur kërcënohen

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,49 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,39**

Në krahasim me vitin 2020 situata është pothuajse e njëjtë. Situata perceptohet të jetë rënduar në disa nuanca për sa i përket sigurisë së gazetarëve, duke pasur parasysh se një nga rastet e ndodhura gjatë vitit përkatës, ai i sulmit fizik ndaj Visar Duriqit, është ende nën hetim. Ashtu si në të kaluarën nuk ka persona kontaktues apo numra të posaçëm për gazetarët për të raportuar rastet e tyre brenda institucioneve dhe gazetarët raportojnë rastet e tyre në të njëjtën mënyrë si çdo qytetar tjetër. Edhe pse nuk dihen dhe as raportohen raste ku institucionet përkatëse nuk janë përgjigjur fare, as përpunojnë apo pranojnë raportim të gazetarëve apo mediave për shkeljen e të drejtave të tyre, ka shumë raste të pazgjidhura nga viti 2021 dhe vitet e mëparshme (Rasti i Shkumbin Kajtazit në 2020; Rasti i Visar Duriqit 2021). PK-ja perceptohet si institucioni më efikas, ndërsa gjykatat më pak bashkëpunuese dhe efektive, për shkak të zvarritjes së rasteve apo moszgjidhjes fare të tyre.

Koordinatorët për t'u marrë me rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve caktohen si në Polici ashtu edhe në Prokurori. Megjithatë, në të dyja këto institucione nuk ka persona kontaktues dhe numra të posaçëm për raportimin e rasteve nga gazetarët. Gazetarët i raportojnë rastet e tyre në të njëjtën mënyrë si çdo qytetar tjetër, ndërsa koordinatorët brenda këtyre institucioneve caktohen të merren me rastin pas raportimit të tyre qoftë në polici, në prokurori apo në gjykata. Gjatë periudhës raportuese ka pasur 29 raste të sulmeve, kërcënimeve, ngacmimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve. Shumica e rasteve janë raportuar përmes Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe Policisë së Kosovës, disa raste janë bërë publike përmes mediave dhe rrjeteve sociale. Rastet e linçimit publik (kryesisht përbëhen nga postime online) zakonisht raportohen vetëm në AGK, ndërkohë që sulmet dhe kërcënimet fizike, si dhe kërcënimet verbale raportohen në PK dhe AGK. PK-ja dhe Prokuroria kanë emëruar koordinatorë që merren me rastet e gazetarëve dhe janë shumë bashkëpunues

— TREGUESI 2.1

me AGK-në. Mirëpo, duke pasur parasysh mungesën e bashkëpunimit të AGK-së me gjyqësorin dhe hezitimin e kësaj të fundit për të qenë bashkëpunues në këtë çështje gjatë dy viteve të fundit janë vetëm disa raste të zgjidhura. Masat që marrin institucionet për mbrojtjen e gazetarëve janë të njëjta sikurse për qytetarët e tjerë. Nuk dihen raste kur institucionet përkatëse nuk janë përgjigjur fare, as nuk kanë përpunuar/ pranuar raportim të një gazetari apo medie në lidhje me shkeljen e të drejtave të tyre. Megjithatë, rastet që marrin më shumë vëmendje janë zakonisht ato të sulmeve fizike dhe kjo për shkak se ndaj tyre reagojnë aktorët më të shquar të politikës dhe/ose organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 2021 i tillë ishte rasti i sulmit fizik të gazetarit Visar Duriqi. Edhe pse ishte rasti më i ashpër i sulmit fizik që ka ndodhur gjatë vitit 2021, ai është ende nën hetim dhe autori(ët) nuk dihen deri më sot.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë qasje në mekanizma të veçantë mbrojtjeje/sigurie

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,51 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,59**

Gjatë vitit 2021, gjendja sa i përket mbrojtjes së gazetarëve me ligjet përkatëse mbetet pothuajse e njëjtë me një vit më parë; megjithatë, perceptohet si një ndryshim pozitiv që organizatat që veprojnë në Kosovë kanë treguar më shumë interes për përfaqësimin ligjor të gazetarëve (pa pagesë). Gjatë vitit 2021 OSBE-ja i ofroi AGK-së një avokat i cili do të përfaqësonte Asociacionin si dhe gazetarët në procedurat ligjore. Për më tepër, dispozitat ligjore, si Kodi Penal i Republikës së Kosovës që mbrojnë çdo person që mund të jetë viktimë e veprave penale për shkak të punës së tij/saj mbrojnë edhe gazetarët, por nuk ka dispozita ligjore që mbrojnë gazetarët më shumë se sa qytetarët e tjerë. Procedura e vlerësimit të rrezikut nuk është e përcaktuar qartë. Megjithatë, nëse policia vlerëson se siguria e gazetarëve është e rrezikuar, mund t'u japë atyre mbrojtje policore.

Të njëjtit mekanizma që vlejné për mbrojtjen e të gjithë qytetarëve vlejné edhe për gazetarët, për faktin se nuk ka mekanizma specifike në nivel kombëtar që ofrojnë mbrojtje fizike për të pambrojturit. Për më tepër, ekzistojné dispozita ligjore, siç është Kodi Penal i Republikës së Kosovës (në fuqi nga 14 prill 2019) që mbron çdo person që mund të jetë viktimë e veprave penale për shkak të punës së tij/saj.

Në sistemin ligjor të Kosovës nuk ka mekanizma të krijuar për vlerësimin e rrezikut ndaj gazetarëve që do t'i dallonin nga qytetarët e tjerë, por në rast se policia vlerëson se rrezikohet siguria e një gazetari (sikurse e çdo qytetari tjetër), i jep mbrojtje të afërt. Në të kaluarën PK-ja i ka ofruar mbrojtje të afërt Shkumbin Kajtazit.

Në vitin 2019 AGK-ja ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), me qëllim që anëtarët e AGK-së të përfitojnë ndihmë juridike falas. Në vitin 2020, OAK-ja u tërhoq nga ky Memorandum Mirëkuptimi në mënyrë të njëanshme, duke i lënë gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave të cënueshëm, veçanërisht gjatë pandemisë. Në vitin 2021, Misioni i OSBE-së në Kosovë i ofroi AGK-së një avokat i cili do të përfaqësonte ligjërisht gazetarët në gjykata. Ndërsa deri në fund të vitit, pas kërkesave të AGK-së dhe OSHC-ve të tjera, gazetarët janë përfshirë si përfitues të Ndhmës Juridike Falas (është themeluar në fillim të vitit 2022). Një organizatë tjetër ku gazetarëve u ofrohet ndihmë juridike falas është Instituti i Kosovës për Drejtësi.

Gazetaret femra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetës kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,57 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,57**

Ngjashëm me vitin 2020, në vitin 2021 janë raportuar në AGK 3 raste të sulmeve, kërcënimeve dhe ngacmimeve ndaj grave gazetare. Këto raste të sulmeve verbale duhej të raportoheshin vetëm në AGK. Megjithatë, grave gazetare nuk u ofrohet asistencë shtesë nga institucionet përkatëse në raport me kolegët e tyre meshkuj apo qytetare të tjera femra.

Vlerësohet si pozitive që diskriminimi me bazë gjinore nuk ndodh brenda institucioneve të sundimit të ligjit, megjithatë llojet e sulmeve ndaj gazetarëve femra nxjerrin në pah diskriminimin me bazë gjinore, sepse kryesit e këtyre veprave përdorin forma të ndryshme presioni dhe gjuhe ndaj gazetarëve femra.

Në prill të vitit 2019 filluan procedurat për miratimin e Konventës së Stambollit në kuadër të legjislacionit të Kosovës, ku më vonë u miratua në shtator 2020. Konventa e Stambollit tashmë është pjesë e të drejtës kushtetuese në Kosovë dhe sipas këtij zotimi institucionet janë të obliguara të ndërmarrin veprime ligjore dhe institucionale për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Konventa e Stambollit. Në nivel lokal Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazinë gjinore si vlerë themelore. Dhuna me bazë gjinore njihet vetëm si formë e diskriminimit sipas Ligjit për Barazi Gjinore. Ligji i Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ofron një përkufizim të dhunës në familje në procedurat civile, duke vendosur kështu bazën për ofrimin e masave mbrojtëse përmes urdhrave të mbrojtjes.

Pavarësisht kornizës ligjore që mbulon disa akte të dhunës me bazë gjinore, mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës dhe holistik të dhunës me bazë gjinore, siç parashihet në Konventën e Stambollit, gjithashtu ndikon në ndjekjen dhe dënimin efektiv të dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Kosova ka miratuar edhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili vlen për të

gjitha veprimet apo mosveprimet e të gjitha institucioneve shtetërore dhe vendore, personave fizikë dhe juridikë, sektorit publik dhe privat, të cilat cenojnë, kanë shkelur apo mund të shkelin të drejtat e çdo personi fizikë dhe juridikë, në të gjitha fushat e jetës. Institucionet kanë krijuar mekanizma për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Në kuadër të Prokurorisë së Shtetit funksionon Zyra për Mbrojtjen e Viktimave e cila gjithashtu përfaqëson rastet e dhunës në baza gjinore, ndërsa në kuadër të Agjencisë për ndihmë juridike falas, ndihma juridike falas u ofrohet viktimave të dhunës në bazë gjinore kur viktimat nuk janë në gjendje të paguajnë atë. Ndihma juridike falas u ofrohet viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të DhBGj-së në të gjitha rastet, pavarësisht gjendjes së tyre financiare. Kjo parashihet me ligjin nr. 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-017 për ndihmën juridike falas. E njëjta gjë vlen edhe për gazetarët. Fillimisht Agjencia për Ndihmë Juridike Falas nuk i përfshiu gazetarët në kategorinë e përfituesve të ndihmës juridike falas, duke qenë se këta të fundit janë të punësuar. Megjithatë, gazetarët me kushte të vështira ekonomike mund të kërkojnë përfaqësim ligjor nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, pasi financat janë një nga kriteret kryesore për këtë dispozitë. Në fund të vitit 2020, si gratë ashtu edhe gazetaret përfshiheshin në kategorinë e përfituesve të ndihmës juridike falas. Gratë gazetare që janë viktimat të ngacmimeve, kërcënimeve dhe/ose sulmeve nuk u ofrohet ndihmë shtesë nga institucionet përkatëse në raport me kolegët e tyre meshkuj. Kodi Penal i Kosovës parasheh përdhunimin, sulmin seksual dhe abuzimin, si disa nga veprat penale kundër integritetit seksual.

Gjatë vitit 2021 nuk ka të dhëna për rastet e raportuara të diskriminimit me bazë gjinore të gazetareve femra. Megjithatë, vlerësohet se institucionet u përgjigjen në mënyrë të duhur të gjitha kërkesave dhe trajtojnë të gjitha viktimat në mënyrë jodiskriminuese. Në Kosovë ngacmimi hyn në kategorinë e veprave penale dhe rregullohet me Kodin Penal të Kosovës, ndërsa diskriminimi rregullohet me ligj të veçantë, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në të dyja rastet e ngacmimit dhe diskriminimit, gazetaret femra mund t'i paraqesin rastet e tyre në institucionet përkatëse, por nuk ofrohet një mbështetje e veçantë ligjore për gazetaret femra në raportimin e këtyre rasteve, e cila dallon nga ajo e të gjitha shtetaseve femra. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ndihmën juridike falas parasheh se personat të cilëve u janë shkelur të drejtat me veprim ose mosveprim që përbën diskriminim, si dhe viktimat e dhunës me bazë gjinore janë kategori të veçanta të përfituesve të ndihmës juridike falas. Kjo do të thotë se në raste të tilla ato mund të kërkojnë ndihmë juridike falas sa herë që përballen me probleme të tilla. Nuk ka pasur asnjë rast elaborues gjatë periudhës raportuese, megjithatë gazetaret femra pohojnë se ndjehen të lira dhe të sigurta për të kërkuar ndihmë nga institucionet shtetërore në rastet e diskriminimit gjinor.

Është vendosur praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,24 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,08**

Numri i sulmeve online nga politikanë dhe zyrtarë të lartë është rritur me pesë në krahasim me vitin 2020 dhe kjo rritje është tregues i rrezikshmërisë dhe jostabilitetit të profesionit të gazetarit, si dhe lirisë së medias. Rastet më të shpeshta të kërcënimeve vijnë nga persona që duhet të mbrojnë të drejtat e gazetarëve dhe të promovojnë lirinë e shprehjes, rrjedhimisht edhe median. Ka hipokrizi në sjelljen e politikanëve për faktin se janë kryesisht ata që përdorin gjuhë poshtëruese ndaj gazetarëve dhe kjo gjuhë zakonisht çon në më shumë kërcënime dhe linçime nga ndjekësit e tyre, veçanërisht në internet.

Edhe pse institucionet qeveritare i njohin sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve si shkelje të lirisë së shprehjes, shkelje të të drejtave të njeriut dhe ligjit penal, zyrtarët publikë kryesisht përmbahen nga deklaratat. Nëse nuk ka sulme fizike ndaj gazetarëve dhe/ose reagime nga shoqata e gazetarëve, organizatat e shoqërisë civile ose vëzhguesit ndërkombëtarë të lirisë së medias, nuk është e zakonshme që politikanët ose zyrtarët e lartë t'i dënojnë ato sulme. Dënimi i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të mediave nga politikanë dhe/ose zyrtarë shtetërorë bëhet kryesisht përmes postimeve të tyre në rrjetet sociale. Duke qenë se këto deklarata nuk janë pjesë e diskursit të tyre të përditshëm, ato i bëjnë vetëm në rastet e sulmeve fizike. Megjithatë, edhe pse këto deklarata kërkojnë dënimin e autorëve, e njëjta praktikë zbatohet edhe në rastet kur përfshihen politikanë apo zyrtarë publikë/shtetërorë. Gjatë vitit 2021 është rritur tendenca e sulmeve verbale ndaj gazetarëve nga zyrtarët politikë dhe të lartë shtetërorë, veçanërisht përmes rrjeteve sociale. Ndërsa në vitin 2020 ka pasur 8 kërcënime dhe sulme verbale ndaj gazetarëve, numri i të njëjtave raste nga zyrtarë të lartë dhe persona publikë është rritur me pesë në vitin 2021. Tre nga 13 raste kanë ndodhur në rajon, ku kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka përdorur një qasje selektive ndaj gazetarëve nga Kosova, të cilët ishin pjesë e konferencës për shtyp me kancelaren gjermane Angela Merkel, ndërsa Adriatik Kelmendi raportoi se ai është marrë në

pyetje nga agjentët e Agjencisë Serbe të Informacionit (BIA), në udhëtimin e tij në Beograd në dhjetor. Si rast i fundit është kryetari i Alternativës për Ndryshim, Shqipërim Arifi, ku ka përdorur fjalor linçues ndaj korrespondentit të Radio Televizionit të Kosovës në Luginën e Preshevës, Baki Rexhepi. Në nëntor të vitit 2021, zyrtari i Vetëvendosjes dhe ish-kandidati për deputet i kësaj partie, Hysamedin Feraj, përdori gjuhë kërcënuese ndaj disa gazetarëve. Këshilltari i Presidentit të Kosovës, Blerim Vela ka përdorur fjalor linçues ndaj mediave. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi, ka kërcënuar median online "Albanian Post" dhe drejtorin e saj, Baton Haxhiun, për shkak të raportimeve të mëhershme. Zyrtarja e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, Anita Xhabiri ka ofenduar një gazetar të Gazetës Express. Zëdhënësi i Kompanisë Kosovare për Shpërndarje të Energjisë Elektrike (KEDS), Viktor Buzhala ka përdorur gjuhë denigruese ndaj gazetares së Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Albijona Hoxhaj dhe kolegëve të saj. Dega e Lidhjes Demokratike të Kosovës - LDK, në Suharekë, ka përdorur gjuhë denigruese ndaj gazetarit Uran Haxha. Dega e partisë politike LDK në Suharekë përmes një postimi në Facebook, e ka linçuar gazetarin Haxha si "këshilltarin nga nëntoka e Bali Muharremajt". Dega e partisë politike Lëvizja Vetëvendosje në Mitrovicë, ka linçuar gazetarë dhe media, duke filluar nga portali lokal "Jepi Zë". Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës përdorën fjalor linçues ndaj RTV Dukagjinit gjatë fushatës elektorale.

Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,98 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,85**

Score (3.85) – Situata u rëndua në vitin 2021 më së shumti për shkak të masave të zgjata në lidhje me pandeminë. Ka pasur dy raste kur gazetarët janë penguar në detyrë nga Policia dhe një rast nga Prokuroria. Në përgjithësi, policia respekton profesionin e gazetarëve dhe priret të mos i pengojë ata të bëjnë punën e tyre. Për më tepër, PK-ja mbetet institucioni më efektiv dhe bashkëpunues me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës.


Organet e sundimit të ligjit në Kosovë, si Policia, Prokuroria dhe Gjykatat organizojnë trajnime për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të tyre dhe ato kryesisht organizohen nga organizatat ndërkombëtare (në këtë rast OSBE-ja), si dhe organizatat vendore, si IKD. Përmes këtyre trajnimeve është rritur vetëdijësimi i pjesëtarëve të PK-së për mënyrën e trajtimit të rasteve në të cilat janë përfshirë gazetarët. Gjithashtu, Akademia e Drejtësisë organizon trajnime për prokurorët dhe gjyqtarët për lirinë e shprehjes. IKD në vazhdimësi zhvillon trajnime për avokatë, gjyqtarë dhe prokurorë për tema si liria e shprehjes, liria e mediave, si dhe për të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. PK-ja ka organizuar trajnime për media me pjesëmarrjen e një numri të zyrtarëve policorë, përmes të cilave ka rritur kapacitetet e brendshme për punë kompetente me media. Prokurorët dhe koordinatorët e caktuar, zëdhënësit, administratorët e prokurorisë, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarë të tjerë kanë marrë pjesë në trajnime për marrëdhënie me mediat, kryesisht të mbështetura nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, edhe pse nevojitet ende trajnim i mëtejshëm. PK-ja ka një bazë të posaçme të dhënash për rastet e gazetarëve dhe është në kontakt të ngushtë me AGK-në e cila monitoron rastet. Megjithatë, asnjë protokoll apo udhëzim që do të ndalonte ngacmimin, frikësimin apo sulmin ndaj gazetarëve nuk është krijuar dhe as miratuar nga PK-ja. PK-ja është një nga institucionet më bashkëpunuese me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës. AGK-ja ka qasje në të dhënat e të gjitha rasteve të sulmeve të raportuara në polici. PK-ja vlerësohet si institucioni më i përgjegjshëm dhe bashkëpunues. Gjatë periudhës raportuese, për shkak të situatës me pandeminë, gjatë vitit 2020 ka pasur tri ndalime ku gazetarët janë penguar

në detyrë nga Policia, por janë liruar pas reagimit të AGK-së. Gjatë periudhës raportuese kanë ndodhur tri raste të pengimit gjatë kryerjes së detyrës. Rasti i parë ka ndodhur në prill të vitit 2021, ku kryeredaktori dhe gazetari i Insajderit, Parim Olluri është marrë në pyetje nga Policia e Kosovës, pasi Gazeta Insajderi kishte publikuar një hetim që përmban informacione të brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë. Rasti tjetër ka ndodhur në nëntor të vitit 2021, pasi dy ekipe televizive, ai i TV Dukagjinit, si dhe i Klan Kosovës, të cilët kanë shkuar në vendngjarje për të raportuar drejtpërdrejt për grabitjen e armatosur në qarqet Prishtinë-Gjilan, janë penguar dhe gjobitur nga Policia e Kosovës; rruga ishte lejuar të përdoret nga qytetarët e tjerë, por jo nga këto dy ekipe televizive. Rasti i fundit ka ndodhur në fund të vitit, gazetari dhe redaktori i portalit "Indeksonline", Alban Muhaxheri është marrë në pyetje për disa orë në Stacionin Policor në Kaçanik, pasi kishte shkruar për një pjesëtar të Policisë në një faqe lokale në Facebook. Megjithatë, nuk ka raste që gazetarëve t'u refuzohet e drejta për të raportuar nga një ngjarje e caktuar me arsyetimin se nuk kanë akreditim gjatë vitit 2021. Ndërsa në vitin 2020, ndalimet kanë ndodhur si pasojë e masave të marra nga qeveria për parandalimin e përhapjes së virusit, kryesisht gjatë kohës së kufizimit të lëvizjes. AGK-ja dhe PK-ja vazhdimisht u kanë bërë thirrje gazetarëve dhe punëtorëve të tjerë të mediave që të mbajnë dokumentet identifikuese të punës si dëshmi.



Procesi i rregullt

3,27



33

Njësitë e specializuara të hetimit dhe/ose oficerët janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,61 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,61**

Gjatë vitit 2021 nuk është bërë asnjë ndryshim sa u përket hetimeve dhe ndjekjeve të specializuara të akteve të dhunës ndaj gazetarëve. Situata mbetet e njëjtë si në vitet paraprake. Sipas praktikave, policia dhe prokuroria nuk kanë profesionalizmin dhe ekspertizën e duhur në lidhje me masat mbrojtëse ligjore në fuqi të parapara me legjislacionin në fuqi në Kosovë, pasi nuk ka udhëzime apo politika të miratuara as nga sistemi prokurorial dhe as nga Policia për trajtimin e rasteve kundër gazetarëve. Krahas emërimit të një koordinatori nga PK-ja dhe Prokuroria, gjykatat kanë caktuar edhe koordinatore të cilët merren edhe me rastet e kërcënimeve, sulmeve dhe ngacmimeve ndaj gazetarëve.

Në kuadër të Prokurorisë së Shtetit është caktuar një prokuror si Koordinator për të koordinuar dhe monitoruar rastet kur gazetarët janë viktima të krimit. Ky koordinator mban edhe bazën e të dhënave për raste të tilla. Po ashtu, Policia e Kosovës (PK) ka caktuar një Koordinator për monitorimin dhe përcjelljen e të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me gazetarët. Për shkak të faktit se bazat e të dhënave përpilohen manualisht, ato nuk janë të besueshme për të pasur një regjistrim të qëndrueshëm dhe të qasshëm të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve. Praktika tregon se policia dhe prokuroria nuk kanë profesionalizmin dhe ekspertizën e duhur lidhur me garancitë ligjore të aplikueshme të parapara nga legjislacioni në fuqi në Kosovë.

Megjithatë, rastet kundër gazetarëve trajtohen nga policia dhe prokuroria në të njëjtën mënyrë si veprat e tjera penale. Siç u tha më lart, Zyra e Prokurorit të Shtetit ka caktuar një

— TREGUESI 3.1

koordinator kombëtar për të monitoruar dhe mbikëqyrur sulmet dhe frikësimet kundër gazetarëve; megjithatë, nuk ka udhëzime apo politika të miratuara as nga sistemi prokurorial dhe as nga policia për trajtimin e rasteve të tilla.

Sa i përket sigurisë së gazetarëve, Policia dhe Prokuroria janë institucionet më efektive dhe bashkëpunuese. Mirëpo, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për gjykatat dhe vendimet e tyre, si rezultat i të cilave shihet se gazetarët hezitojnë të vazhdojnë më tej me lëndët e tyre. Megjithatë, nuk janë hartuar politika të veçanta nga institucionet shtetërore që mbrojnë veçanërisht gazetarët. Të gjitha veprimet e ndërmarra nga ky institucion i sigurisë kryhen në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me organet tjera kompetente. Sa i përket sigurisë së gazetarëve, Prokuroria dhe Gjykata Themelore në Prishtinë kanë caktuar edhe koordinatore për mbledhjen e të dhënave në rastet që përfshijnë gazetarë.

Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, tërësisht dhe menjëherë)

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,02 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,02**

Situata sa i përket këtij treguesi nuk është përmirësuar gjatë vitit 2021. Efikasiteti me të cilin hetimet në rastet kur përfshihen gazetarë nuk është përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme. Gazetarët vazhdojnë të përballen me zvarritje të lëndëve nga gjykatat, ndërsa këto procedura mbeten të patrajtuara me prioritet. Për më tepër, në përgjithësi, sistemi i drejtësisë është i ngadaltë dhe joefektiv dhe disa raste të sulmeve ndaj gazetarëve mbeten të pandëshkuar. Herë pas here, sulmet ndaj gazetarëve nuk konsiderohen si vepra penale, duke i detyruar gazetarët të bëjnë padi private në vend që të ndiqen sipas detyrës zyrtare. OShC-të dhe media, së bashku me Shoqatën e Gazetarëve, janë ato që iniciojnë reagimin e publikut. Procedurat gjyqësore mbeten problematike, duke qenë se nuk trajtohen me prioritet nga gjykatat, ndërsa reagimi i Policisë dhe Prokurorisë vjen menjëherë pas sulmit.

Në mënyrë tipike, hetimet kundër autorëve të veprave ndaj gazetarëve janë të paanshme. Megjithatë, hetimeve, ndjekjeve penale dhe gjykimit të këtyre rasteve u mungon profesionalizmi dhe ekspertiza. Aktualisht, hetimet që përfshijnë gazetarë nuk bazohen në një qasje gjithëpërfshirëse sipas OSHC-ve që monitorojnë sistemin prokurorial dhe gjyqësor. Hetimet fokusohen kryesisht në veprat penale të sulmit dhe kanosjes ndaj gazetarëve. Megjithatë, deri më sot asnjë rast nuk është hetuar apo ndjekur penalisht menjëherë në lidhje me ndonjë motiv politik apo ndonjë lidhje tjetër me grupin e interesit kundër gazetarëve.

Sa herë që gazetarët janë viktimë të një krimi, institucionet shtetërore kanë një qasje të dyfishtë për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të tyre. Policia dhe prokuroria zakonisht veprojnë me urgjencë dhe prioritet menjëherë pas një sulmi, pasi reagimi i publikut zakonisht inicohet nga Shoqata e Gazetarëve, mediat dhe OSHC-të. Megjithatë, atëherë procedurat gjyqësore nuk trajtohen me prioritet as nga prokuroria dhe as nga gjykatat.

Sipas afateve ligjore në procesin hetimor, prokurori i shtetit ose duhet të ngrejë aktakuzë ose të hudhë kallëzimin penal brenda 24 muajve. Lëndët kundër gazetarëve zgjasin më shumë seç duhet, sepse gjykatat nuk respektojnë afatet ligjore, duke shkelur parimin e trajtimit të lëndës brenda një kohe të arsyeshme. Veprat penale të sulmit janë më së shpeshti kundër gazetarëve. Duke respektuar masat mbrojtëse të parapara nga legjislacioni në fuqi, gazetaria konsiderohet një profesion me interes publik.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efikase nga forma të ndryshme të ngacmimeve në internet

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,16 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,04**

Situata në lidhje me sigurinë e gazetarëve është përkeqësuar gjatë vitit 2021. Edhe pse reagimi i policisë në të shumtën e rasteve ka qenë i menjëhershëm, problematik është fakti që deri më sot nuk ka dispozita në ligjet në fuqi që njohin ngacmimin online ndaj gazetarëve, kur ata janë viktimë të një krimi të tillë, duke pasur parasysh se gazetarët janë caqe të veçanta të këtij lloji ngacmimesh në krahasim me profesionistët e tjerë. Gjatë vitit 2021 gazetarët në Kosovë u vunë në shënjestër të dhjetë sulmeve online, frikësimeve, kërcënimeve dhe fyerjeve, veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore. Si pasojë e reagimit të ngadaltë dhe mungesës së efikasitetit të institucioneve të drejtësisë në trajtimin e lëndëve penale dhe civile ndaj gazetarëve, masat ligjore ishin pothuajse joefektive. Zakonisht ofendimet dhe gjuha denigruese vijnë nga zyrtarë të lartë dhe persona me ndikim. Reagimi i shpejtë i PK-së në rastet e Vehbi Kajtazit, G.G. dhe Sh.K. konsiderohen përmirësim nga vitet e kaluara; megjithatë, sistemi i drejtësisë ka ende një rrugë të gjatë në vendosjen e dispozitave specifike kur bëhet fjalë për ngacmimin online kundër gazetarëve.

Ngacmimi online është i inkriminuar penalisht me Kodin e Kosovës. Bazuar në këtë Kod, kushdo që angazhohet në një model të vëmendjes ose komunikimit të përsëritur dhe të padëshiruar me qëllim "për të ngacmuar, frikësuar, plagosur, dëmtuar pronën ose vrarë një person tjetër ose fëmijët e tij ose të saj, familjen, të afërmit ... dhe gjatë kësaj, vende që ai person nga frika e arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pronës ose shqetësimi thelbësor emocional dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet." Ndërsa Kodi Penal nuk parasheh veprën penale specifike të ngacmimit të gazetarit, dispozita e mësipërme zbatohet edhe për gazetarët kur ata janë viktimë të një krimi të tillë.

Fillimisht, rastet e gazetarëve kryesisht raportohen në Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, me përjashtim të

rasteve të sulmeve fizike dhe ose të rrezikshme për jetë (rasti Visar Duriqi) kur policia thirret në vendin e ngjarjes. Policia është e gatshme të bashkëpunojë me viktimën, por edhe me AGK-në. Në përgjithësi, institucionet janë përgjegjëse dhe i marrin seriozisht rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, si në rastet e protestave në veri të Mitrovicës (në fillim të gjitha ekipet gazetareske, më pas rasti i ekipit të Kanal 10). Duhet theksuar se ka mospërputhje në bazën e të dhënave të PK-së dhe atë të AGK-së, sepse ka raste të cilat janë raportuar vetëm në AGK, si: shpifje dhe fyerje verbale, kryesisht përmes rrjeteve sociale. Në anën tjetër, në PK janë raportuar raste të gazetarëve që nuk kanë të bëjnë me profesionin që ushtrojnë, por me çështje personale.

Gjatë vitit 2020, gazetarët në Kosovë u janë nënshtruar 8 sulmeve, frikësimeve, kërcënimeve dhe fyerjeve online, ndërsa gjatë periudhës raportuese ky numër është rritur për dy. Gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në fillim të vitit 2021, pati raste të shumta të fyerjeve dhe frikësimeve ndaj gazetarëve për raportimin dhe opinionet e tyre të përbashkëta. Për shkak të reagimit të ngadaltë të institucioneve të drejtësisë dhe mungesës së efikasitetit të trajtimit të rasteve ndaj gazetarëve në procedurat penale dhe civile, masat ligjore të aplikueshme ishin pothuajse joefektive. Në rastin e Vehbi Kajtazit, pas raportimit të dhjetëra kërcënimeve online, janë identifikuar dhe arrestuar dy të dyshuar për kërcënime online ndaj gazetarit. Të dyshuarit pas intervistimit me vendim të prokurorit kujdestar janë dërguar në mbajtje. Prokuroria Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2021 ka kërkuar masën e paraburgimit për dy të pandehurit R.S. dhe T.P. pasi dyshohet se kanë kryer veprën penale "Ngacmim" dhe "Kanosje" ndaj gazetarëve G.G. dhe Sh.K. – këto të dhëna janë mbledhur nga raporti ditor i Policisë së Kosovës (më 3 dhjetor 2021). Sipas aktakuzës, i pandehuri R.S. ka kryer veprën penale të ngacmimit ndaj gazetarit të dëmtuar Sh.K., duke i kërkuar që të heqë artikullin e tij nga portali përkatës. Ndërsa, sipas aktakuzës, i pandehuri T.P. ka kryer veprën penale të kanosjes së të dëmtuarit gazetar G.G. përmes rrjetit social Facebook. Prokurori i Shtetit, me aktvendim për paraburgim, të pandehurin e kishte ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh dhe kishte parashtruar kërkesë për caktimin e paraburgimit, si dhe kishte proceduar aktakuzat në gjykatë për trajtim të mëtutjeshëm.

Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,18 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,18**

Në lidhje me procedurat hetimore dhe procedurat gjyqësore nuk u identifikua asnjë progres apo përkeqësim gjatë vitit 2021. Për shkak të faktit se SMIL (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve) nuk është krijuar edhe gjatë vitit 2021, gjykatat nuk arrijnë të ofrojnë informacionin e nevojshëm në lidhje me lëndët duke përfshirë edhe gazetarët. Ndërkohë, që nga tendenca për të rishikuar Kodin e Sjelljes në vitet 2019-2020, që do të kufizonte mundësinë e gazetarëve për të raportuar nga seancat gjyqësore, nuk ka pasur asnjë tentativë tjetër si të tillë. Megjithatë, vlerësohet se transparencja në mënyrën se si zhvillohen procedurat gjyqësore për sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave nuk është e kënaqshme.

Sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi në Kosovë, viktimat e krimit kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave e cila është themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Kjo zyrë ofron asistencë profesionale për viktimat e krimit dhe ka detyrimin të kërkojë nga prokuroria dhe gjykatat respektimin dhe promovimin e të drejtave të viktimave gjatë të gjitha fazave të procesit gjyqësor. Nuk ka asnjë informacion të disponueshëm se ndonjë gazetar ka kërkuar mbështetje ose ka marrë ndihmë nga kjo zyrë. Kur qytetarët apo gazetarët janë viktimat e krimit në Kosovë, prokurorët e shtetit rrallë i informojnë ata për ecurinë e procedurës penale dhe as nuk u japin atyre qasje në shkresat e lëndës. Bazuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë, janë prokurori dhe gjyqtari i rastit ata që japin informacione lidhur me statusin e secilit rast. Zëdhënësja e çdo prokurorie dhe gjykate jep informacion mbi statusin e lëndës bazuar në reagimet e marra nga prokurori ose gjyqtari, përkatësisht. Nuk ka pasur raste të raportuara të gazetarëve që nuk u është dhënë qasje në gjykatën e hapur dhe as në vitin 2021 apo në dy vitet e fundit. Vlerësohet se

— TREGUESI 3.4

seksionet e shtypit dhe departamentet e marrëdhënieve me publikun brenda institucioneve japin informacionin e nevojshëm për gazetarët. Për më tepër, gazetarëve u jepet qasje në seancat gjyqësore në mënyrë jodiskriminuese, pa asnjë kufizim, përveç rasteve gjyqësore të urdhrave të gjyqtarëve për masa mbrojtëse. Megjithatë, në vitet 2019-2020 ka pasur një tendencë për të rishikuar Kodin e Sjelljes, i cili do të kufizonte aftësinë e gazetarëve për të raportuar nga seancat gjyqësore, duke i detyruar ata të prisnin deri në vendimin përfundimtar. Pas shqetësimeve të ngritura nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, kjo tentativë është pezulluar nga KPM-ja.

Sistemet e grumbullimit të statistikave cilësore të krijuara nga autoritetet shtetërore për të frenuar mosndëshkimin

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,76 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,65**

Situata në Kosovë mbetet pothuajse e njëjtë. Megjithatë, është shqetësues fakti se mjeti i ndarjes së të dhënave nuk është krijuar ende në gjykata dhe këto të fundit nuk mund të japin asnjë statistikë për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Është e një rëndësie të madhe që SMIL të funksionalizohet, sepse do të konsolidonte të dhënat dhe statistikat jo vetëm që kanë të bëjnë me gazetarin por edhe për të gjitha lëndët penale dhe civile në gjyqësor. Është gjithashtu e rëndësishme që sistemi informativ i menaxhimit të lëndëve të jetë i ndërlidhur me sistemin informativ të Policisë së Kosovës në mënyrë që të rritet komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe prokurorisë në trajtimin e rasteve kundër gazetarëve.


Raportet statistikore të qasshme për publikun publikohen çdo vit nga institucionet shtetërore si Policia, Prokuroria dhe Gjykata. Ndonëse, këto të dhëna nuk janë të besueshme dhe nuk janë të ndara për fusha të veçanta F74a dhe janë të dhëna më tepër të përgjithshme, të cilat nuk japin informacion, statistika apo të dhëna konkretisht vetëm për rastet kur gazetarët janë viktima të veprave penale. Nuk ka diferencim apo gjenerim të statistikave në bazë të fazës së procedurës penale në rastet kur gazetarët janë viktima të krimit, as në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike apo ndonjë faktori tjetër socio-demografik.

Edhe pse Gjyqësori dhe Prokuroria kanë pretenduar të krijohet sistemi informativ i menaxhimit të lëndëve, kjo nuk ka ndodhur as në vitin 2021.

IV

Siguria aktuale

3,01



43

Kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike

Këto mund të përfshijnë: mbikëqyrja ose përcjellja; telefonata ngacmuese; ngacmimet arbitrare gjyqësore ose administrative; deklaratat agresive nga zyrtarët publikë; format e tjera të presionit që mund ta rrezikojnë sigurinë e gazetarëve në ushtrimin e punës së tyre. Këto lloje të kërcënimeve nuk përfshijnë sulmet në turma ose ngacmimin në mjedisin e punës.

Vlerësimi për vitin 2020: 2,92 /

Vlerësimi për vitin 2021: 2,64

Në krahasim me vitin paraprak, ku janë raportuar 11 raste në AGK, gjendja është përkeqësuar, përveç rritjes së numrit të sulmeve, është përkeqësuar edhe në llojin e sulmeve. Kërcënimet dhe sulmet ndryshojnë nga ato të zyrtarëve të lartë ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të mediave, tek ato të institucioneve të sundimit të ligjit, si dhe zyrtarëve të lartë të partive politike. Prokuroria ka qenë e përfshirë në dy nga trembëdhjetë rastet, edhe pse AGK-ja ka kërkuar nga Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës që t'u bëjë thirrje prokurorëve që të respektojnë Kushtetutën dhe të veprojnë në përputhje me ligjin.

Në krahasim me vitin 2020 ku në bazën e të dhënave të AGK-së janë regjistruar 11 raste, gjatë periudhës raportuese numri i kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike ndaj gazetarëve është rritur për dy raste. Llojet e shkeljeve ndaj gazetarëve nuk ndryshojnë shumë nga një vit më parë, pasi ato vijnë kryesisht nga biznesmenë, ish-funksionarë publikë, individë të afërt me partitë politike.

Gazetari Mentor Gjergjaj i cili me urdhër të Prokurorisë Themelore në Gjakovë është ftuar të paraqitet në Stacionin Policor në Gjakovë për t'u intervistuar për një rast lidhur me një shkrim të publikuar nga gazetari më 3 maj 2018, në gazeta online "Gazeta Express". Ndërkohë Parim Olluri i Gazetës Insajderi është intervistuar nga Policia e Kosovës, pasi Gazeta Insajderi një natë më parë kishte publikuar një hetim që përmbante informacione të brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me refuzimin e vaksinave Pfizer dhe BioNtech nga kjo ministri. Dy raste të qasjes selektive jashtë vendit kanë ndodhur gjatë vitit 2021 ndaj gazetarëve të Kosovës. I pari ndodhi në Shqipëri, gjatë takimit të kryeministrit shqiptar Edi Rama me kancelaren gjermane Angela Merkel, ku gazetarët kosovarë u diskriminuan dhe nuk u lejuan të bënin pyetje; dhe e dyta ka ndodhur në Beograd, ku Adriatik

Kelmendi është marrë në pyetje nga BIA me ardhjen e tij në territorin serb dhe jo për herë të parë. Ndërkohë, zyrtarët e PK-së janë përfshirë në dy raste të kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike të raportuara gjatë vitit 2021. Zyrtarët e PK-së kanë gjobitur dhe penguar gjatë kryerjes së detyrës ekipet e Klan Kosova dhe TV Dukagjini në qarkun Prishtinë-Gjilan, derisa kanë tentuar të raportojnë për një grabitje të ndodhur aty. Rasti i dytë ishte ai i Albion Muhaxhirit të portalit Indeksonline, ku për shkak të një komenti në Facebook është marrë në pyetje nga policia në Kaçanik. Hysamedin Feraj i VV-së, si dhe dega e LDK-së në Suharekë kanë përdorur edhe gjuhë linçuese ndaj gazetarëve, ndërsa grupi #MeKryeministrin në Facebook ka vazhduar gjuhën denigruese ndaj gazetarëve dhe mediave.

Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

Këto mund të përfshijnë: referencat për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; referencat për t'iu shkaktuar dëm fizik gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve. Këto kërcënime mund të: bëhen drejtpërdrejtë ose përmes palëve të treta; përçohen përmes komunikimeve elektronike ose në mënyrë fizike; mund të bëhen fshehtë dhe sheshazi.

**Vlerësimi për vitin 2020: 2,78 /
Vlerësimi për vitin 2021: 2,54**

Siguria e gazetarëve është rënduar gjatë vitit raportues, në krahasim me vitet e mëparshme. Ndërsa në vitin 2020 ka pasur gjashtë raste në vitin 2021 janë dhjetë raste të kërcënimit të jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve. Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve janë bërë kryesisht përmes mediave sociale, përmes mesazheve private apo postimeve publike.

Në vitin 2020 janë regjistruar 6 kërcënime me qëllim rrezikimin e sigurisë fizike apo jetës së gazetarëve, ndërsa në vitin 2021 ky numër është rritur me katër raste. Shumica e rasteve të raportuara janë nga qytetarët, kryesisht të lidhura me personat për të cilët kanë raportuar media të caktuara. Gazetarët e Gazetës Sinjali janë kërcënuar nga familjarët e një grupi personash të arrestuar për komplete për terrorizëm, Bujar Vitija i Gazetës Shneta është kërcënuar nga një familjar i anesteziologut për të cilin portali i lartpërmendur raportohet se është gjobitur nga Inspektorati Shëndetësor për faktin se është larguar nga vendi i punës gjatë ndërrimit të kujdestarisë. Deputeti i Vetëvendosjes, Haki Abazi ka kërcënuar portalin "Posta Shqiptare" dhe drejtorin e saj Baton Haxhiun lidhur me disa raportime të mëparshme për dështimin në emërimin e ambasadorëve të rinj të Kosovës, ndërsa këshilltari i Presidentit, Blerim Vela, përdori gjuhë denigruese ndaj mediave.

Sulmet fizike

Këto mund të përfshijnë: lëndimin fizik ose mendor, kidnapimin, hyrjen me forcë në shtëpi/zyrë, zaptimin e pajisjeve, mbajtjen arbitrare, përpjekjet e dështuara për vrasje, etj.

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,48 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,40**

Numri i sulmeve aktuale ndaj gazetarëve është ulur me një në vitin 2021. Megjithatë, llojet e incidenteve përfshinin një nga sulmet fizike më të ashpra të regjistruara ndonjëherë në bazën e të dhënave të AGK-së. Rasti i Visar Duriqit mbetet nën hetim dhe asnjë nga autorët nuk është vënë para drejtësisë.

Gjatë vitit 2020 ka pasur gjithsej katër sulme fizike ndaj gazetarëve, ndërsa në vitin 2021 ky numër është ulur me një rast. Rasti i parë ka ndodhur në shkurt të vitit 2021, ku gazetari Visar Duriqi është sulmuar fizikisht nga persona të panjohur në afërsi të banesës së tij në mesnatë. Kjo nuk ishte hera e parë që Duriqi kërcënohej për shkak të temave që trajton; megjithatë, kjo ishte hera e parë që ai u sulmua fizikisht. Ndërkohë dy rastet e tjera ndodhën në Mitrovicën e Veriut, ku gazetarët shqiptarë dhe serbë po sulmoheshin nga protestuesit në rrugë si gr rup. Në të njëjtën ditë, Albulena Rexha e Kanal 10 është hedhur me mjete piroteknike teksa raportonte nga e njëjta ngjarje.

Kërcënimet dhe sulmet ndaj organizatave mediale dhe asociacioneve të gazetarëve

Kërcënimet mund të përfshijnë: telefonatat ngacmuese, ngacmimet arbitrare gjyqësore apo administrative; deklaratat agresive nga zyrtarët publikë; format e tjera të presionit (mbishkrimet, postimet kërcënuese, etj.). Sulmet përfshijnë: hyrja e paautorizuar në zyre, zaptimi i pajisjeve, thyerja e pajisjeve, veturave, etj.

**Vlerësimi për vitin 2020: 3,68 /
Vlerësimi për vitin 2021: 3,46**

Situata dhe numri i rasteve të raportuara në AGK gjatë vitit paraprak ishte gjithashtu tre. Megjithatë, rastet e vitit 2021 përfshinin zyrtarë nga tri parti kryesore politike. Prandaj, vlerësimi i përgjithshëm i AGK-së është se situata në vitin 2021 është përkeqësuar pak në krahasim me vitin paraprak.

Edhe pse numri i rasteve të regjistruara si kërcënime dhe sulme ndaj institucioneve mediatike, organizatave, mediave dhe shoqatave të gazetarëve mbetet i njëjtë me vitin e kaluar, në vitin 2021 dy prej rasteve kanë ardhur nga tri parti kryesore politike në vend. Rasti i parë ndodhi në fund të janarit, gjatë fushatës së zgjedhjeve qendrore. Partitë politike, PDK dhe LDK kanë përdorur gjuhë denigruese ndaj TV Dukagjinit. Më pas, Lëvizja Vetëvendosje dega në Mitrovicë kërcënoi por edhe bojkotoi portalin lokal "JEPI ZË". Ndërsa kamera dhe taksia e ekipit të Radio Evropa e Lirë/Radio Liberty janë dëmtuar nga një grup prej rreth 50 personash, të cilët do ta pengonin ekipin të raportonte nga trazirat në Mitrovicën e Veriut.

Titulli origjinal
Western Balkans Journalists' Safety
Index Narrative Report Kosovo 2020

Publikues
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



Autore:
Getoarbë Mulliqi Bojaj

Ekspert ligjor:
Yll Zekaj

Ekspert nacional:
Abit Hoxha

Dizajni
comma.rs

Ky botim u prodhua me ndihmën e Bashkimit
Evropian dhe Civil Rights Defenders.
Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi
vetëm e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës
dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merren
për të reflektuar pikëpamjet e Bashkimit
Evropian dhe Civil Rights Defenders.

